

Nr. Prot.: 93/2025

 Datë: 07.07.2025

Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenit 35 të Statutit të Kolegji ISPE, Shkolla e Mesme e Mjekësisë në kuadër të Kolegjit ISPE, shpallë Konkurs për vende të lira të punës:

K O N K U R S

PËR VENDE TË LIRA TË PUNËS

Për Lëndët e Përgjithshme:

Nr.	Niveli	Pozita	Vend i lirë	Numri i pozitave
1.	SHMLP	Mësimdhënës/e për Gjuhë shqipe dhe letërsi	Vend i lirë	2
2.	SHMLP	Mësimdhënës/e për Gjuhë angleze	Vend i lirë	1
3.	SHMLP	Mësimdhënës/e për Gjuhë gjermane	Vend i lirë	1
4.	SHMLP	Mësimdhënës/e për Matematikë	Vend i lirë	2
5.	SHMLP	Mësimdhënës/e për TIK	Vend i lirë	1
6.	SHMLP	Mësimdhënës/e për Edukatë fizike	Vend i lirë	1
7.	SHMLP	Mësimdhënës/e për Fizikë	Vend i lirë	1
8.	SHMLP	Mësimdhënës/e për Biologji	Vend i lirë	1
9.	SHMLP	Mësimdhënës/e për Kimi	Vend i lirë	1
10.	SHMLP	Mësimdhënës/e për Psikologji	Vend i lirë	1

Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në Kolegjin ISPE);
- CV-ja e kandidatit;
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diploma (ose Certifikatat), *certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit, nuk do të merret parasysh;*
- Certifikata që nuk jeni nën hetime.
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimdhënës

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e Arsimit dhe Aftësisë Profesionale si dhe fushën e Arsimit Parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimet Administrative përkatëse të MASHTI-it (UA Nr. 05/2015 dhe UA Nr. 05/2021) si dhe procedurave të përcaktuara me Rregulloret e Brendshme të Kolegjit ISPE.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Lëndët e Përgjithshme:

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
- Sistemi katër vjeçar;
 - Bachelor (katër vjeçar 240 ECTS).

Për Kualifikimet dhe Modulet Profesionale:

Nr.	Niveli	Pozita	Vend i lirë	Numri i pozitave
1.	SHMLP	Mësimdhënës/e për Kualifikimin: Teknik Dentar	Vend i lirë	4
2.	SHMLP	Mësimdhënës/e për Kualifikimin: Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë	Vend i lirë	4
3.	SHMLP	Mësimdhënës/e për Kualifikimin: Asistent i Fizioterapisë	Vend i lirë	3
4.	SHMLP	Mësimdhënës/e për Kualifikimin: Teknik i Farmacisë	Vend i lirë	3
5.	SHMLP	Mësimdhënës/e për Kualifikimin: Teknologji e Informacionit Komunikimit dhe Elektronikë	Vend i lirë	3

Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në Kolegjin ISPE);
- CV-ja e kandidatit;
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diploma e **Kualifikimit** (ose Certifikatat), *certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit, nuk do të merret parasysh;*
- Certifikata që nuk jeni nën hetime.

- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimdhënës

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e Arsimit dhe Aftësisit Profesional si dhe fushën e Arsimit Parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimet Administrative përkatëse të MASHTI-it (UA Nr. 05/2015 dhe UA Nr. 05/2021) si dhe procedurave të përcaktuara me Rregulloret e Brendshme të Kolegjit ISPE.

Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Kualifikimet dhe Modulet Profesionale

Për Kualifikimin: Teknik Dentar:

- Specialist i Stomatologjisë;
- Doktor i Stomatologjisë.

Për Kualifikimin: Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë:

- Master i Shkencave të Infermierisë;
- Master i Infermierisë dhe Mamive;
- Mjek specialist.

Për Kualifikimin: Asistent i Fizioterapisë:

- Master i fizioterapisë;
- Fizioterapeut i diplomuar.

Për Kualifikimin: Teknik i Farmacisë:

- Mr.Ph;
- Farmacistë i diplomuar.

Për Kualifikimin: Teknologji e Informacionit Komunikimit dhe Elektronikë:

- Master në Shkenca Kopjuterike;
- Master në Inxhinieri Kopjuterike;
- Master i Programit Teknologji-Informatikë.

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar.

Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohet intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri 100 pikë apo 50% e vlerësimit përfundimtar.

Vlerësimi në intervistimin me gojë, bazohet në këto kriterë:

- Njohuritë e Përgjithshme 25 pikë,
- Aftësitë e përgjithshme dhe Personalitetit 35 pikë dhe
- Njohuritë profesionale 40 pikë (Ku përfshihen përvoja e punës dhe kualifikimi profesional gjatë studimeve).

Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në pozitat e lartcekura.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur nga dita e shpalljes së konkursit deri më datën 21.07.2025.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në Kolegjin ISPE në Adresën: Rr. "Enver Maloku, Nr. 49, Bregu i Diellit, Prishtinë, apo në e-mail adresën zyrtare të Kolegjit ISPE: info@kolegji-ispe.org



Për informata më të hollësishme kontaktoni në:

+383 (0) 44 674 566

+383 (0) 45 700 744

www.kolegji-ispe.org

Drejtor: Avni Mazreku



Prishtinë, 07.07.2025